

Si duhet të ushqehen dhe trajtohen viçat e sapolindur me diare

Është sëmundja që sjell humbjet më të mëdha në viçat e sapolindur. Sesi duhet të ushqehen dhe të trajtohen viçat e sapolindur me diare mund ta mësoni tek AUSTRIA PRAEMIX.

AUSTRIA PRAEMIX, një bashkim me Schaumann- Agri- International ka hapur në fillim të këtij viti një magazinë të re dhe sjell rregullisht specialistë nga Austria për seminare dhe këshillime për fermat në Shqipëri.

AUSTRIA PRAEMIX ofron përzierje vitaminash dhe lëndë minerale, të cilat përzihen me koncentratet për të gjithë kategoritë e kafshëve. Pikat kryesore janë shpendët, derrat dhe gjedhi. Ne furnizojmë të gjithë fabrikat e ushqimit të blegtorisë dhe fermat, të cilët bëjnë përzierjen e koncentrateve në fermë.

Për diarenë e të porsalindurëve mund të flitet – pavarësisht arsyeve të saj – atëherë kur viçat e sapolindur sëmuren nga diareja në javën e parë, të dytën deri në javën e tretë pas lindjes. Është sëmundja që sjell humbjet më të mëdha tek viçat e sapolindur. Pavarësisht shkaktarëve, për shkak të diaresë viçi humbet shumë lëngje, elektrolite dhe lëndë ushqyese. Humbja ditore e lëngjeve gjatë diaresë të shkallës së mesme shkon në 8-10% të peshës trupore (afërsisht 3-4 litra tek një viç me peshë 40 kg), tek një diare më e fortë këto humbje shkojnë deri në 20% të peshës trupore.

Dobësimi si pasojë e dietës

Tharja (rrudha të lëkurës, kokërdhoku i syrit varet, qëndrim shtrirë pa lëvizur) si pasojë e humbjes së lëngjeve dhe rritja e aciditetit në gjak (përkeqësim i gjendjes së përgjithshme, qëndrim shtrirë pa lëvizur) janë pasojat e zakonshme të diaresë për arsye të humbjes së lëndës rezervë. Arsyet pse ky problem shfaqet shpesh do të shpjegohet më poshtë.

Mos e hiqni qumështin

Në të kaluarën këshillohej që gjatë diaresë viçit t'i ndërpritej ushqyerja me qumësht dhe në vend të kësaj gjatë periudhës së diaresë ose minimumi për “disa ditë” i jepej vetëm pije me elektrolite dhe glukozë. Fatkeqësisht kjo mënyrë praktikohet ende edhe pse sipas njohurive më të reja teknikisht nuk mund të mbështetet më. Sot dihet se nevojat e viçit për energji nuk plotësohen me këto lëngje. Viça, të cilët nuk ushqehen me qumësht për disa ditë dobësohen dukshëm. Kafshë të tilla të dobësuara janë më të ekspozuara kundrejt sëmundjeve të tjera. Nëse ato nuk ngordhin për arsye të diaresë ose nga sëmundjet e tjera (për shembull gripi i gjedhit), ato shpesh ngordhin pas disa ditësh ose disa javësh nga dobësimi- viçat ngordhin nga uria për shkak të dietës.

Humbjet në viça nga uria për shkak të mungesës së energjisë

Në kërkim të shkaqeve në humbjet në viça mendohet për të gjithë viruset e mundshëm dhe arsyeve nga më spektakolaret, por çuditërisht nuk mendohet se ngordhja mund të ketë ndodhur për shkak të mangësive të energjisë në racion. Përvoja në fermën tonë si dhe këshillimi me një numër të madh të fermerëve dhe të ashtuquajturëve mjekë veterinerë tregojnë se dhënia e “Lëngjeve zëvendësuese dhe dietike” si dhe dhënia e lëngjeve me elektrolite në vend të qumështit (të cilat duhet të ofrohen si lëngje ndërmjet kohës së dhënies së qumështit; *shiko planin e pirjes*) sjellin dëme të mëdha tek viçat.

Pirja dhe trajtimi

Në princip për trajtimin e viçave me diare janë të vlefshme të njëjtat principe si tek foshnjat e sëmura me diare. Një mjekim “kundër diaresë” nuk ekziston- për shumë arsye.

Masat e nevojshme për trajtim e diaresë dalin nga pasojat e përshkruara më sipër janë plotësisht të pavarura nga shkaqet e diaresë. Masat më me përparësi janë si më poshtë:

- Mbulimi i nevojave për lëndë ushqimore dhe energji
- Zëvendësimi i humbjeve të lëngjeve dhe elektroliteve
- Balancimi i aciditetit në gjak

Mbulimi i nevojave për energji

Për sa kohë që viçat pijnë (kjo ndodh gati gjithmonë në fillim të diaresë) duhet që nevojat për lëndë ushqyese dhe energji të mbulohen nga një racion i plotë qumështi. Nevoja ditore është rreth 12% e peshës trupore të viçit. Sasia totale e qumështit duhet të ndahet në 3 vakte (shiko planin e pirjes) sepse kështu tretja dhe fermentimi kanë një ecuri optimale. Viçi me diare ngopet me qumësht si viçi i shëndoshë- merr të paktën sasi të barabartë energjie.

Sipas kërkimeve të reja shkencore dhe përvojave në fermë të viteve të fundit dieta e viçave me diare nuk është e nevojshme madje është e dëmshme. Një krahasim i kohëzgjatjes së sëmundjes dhe zhvillimit të peshës ndërmjet viçave me diare të cilët janë në dietë dhe atyre që ushqehen me qumësht (shiko planin e pirjes) ka dhënë rezultatet e mëposhtme:

- Kohëzgjatje e njëjtë e sëmundjes- mesa duket kjo vërteton që ushqyerja me qumësht tek viçat me diare nuk është e dëmshme!
- Viçat që u ushqyen me racion të plotë të qumështit shtuan peshë edhe pse ishin me diare, ndërsa viçat të cilët u ushqyen me lëngje dietike u dobësuan.
- Edhe viçave me diare që u ushqyen me qumësht pa limit 3 herë në ditë, sëmundja e tyre nuk zgjati më shumë se tek viçat e një grupi kontrolli, por ata shtuan 600 gramë në ditë!

Duke konsideruar këto njohuri shkencore dhe përvojën disa vjeçare në mijëra raste të viçave me diare pranë fermës tonë këshillohet që gjatë diaresë të mos ndërpritet dhënia e qumështit. Ky plan pirjeje i cili është pasqyruar më poshtë në këtë artikull ka qenë i sukseshëm gjatë viteve të fundit dhe prandaj është i këshillueshëm.

Plani i pirjes për viçat e sapolindur me diare

(peshat trupore e viçit: 40-50 kg)

Në mëngjes	1,5-2 litra qumësht ¹
Paradite ²	1-1,5 litra lëng me elektrolite ³
Në drekë	1,5-2 litra qumësht ¹
Pasdite ²	1-1,5 litra lëng me elektrolite ³
Në darkë	1,5-2 litra qumësht ¹
Në darkë vonë ²	1-2 litra lëng me elektrolite ³

1-) Nevoja ditore për qumësht: 12% e peshës trupore

2-) Koha në mes të vakteve të ushqyerjes me qumësht duhet të jetë afërsisht 2 orë

3-) Lëngjet me elektrolite treten në ujë të ngrohtë dhe viçit i jepen nëpërmjet kovave me biberon (ato mund të pihen edhe të ftohta)

Zëvendësimi i humbjeve të lëngjeve, elektroliteve dhe lëndës pufërike

Menjëherë sapo të fillojë diareja humbjet duhet të zëvendësohen me lëngje shtesë elektrolitesh. Këto jepen të pihen në mes të vakteve të ushqyerjes me një distancë prej afërsisht 2 orësh (shiko planin e pirjes). Sipas shkallës së diaresë viçave ju ofrohen 3 herë në ditë 1-2 litra në një kovë me biberon. Substanca tretet në ujë të ngrohtë- ato mund të pihen nga viçat edhe “të ftohta”. Dhënia e çajit me kripëra dhe glukozë ashtu siç praktikohet shpesh nuk është e mjaftueshme sepse nuk i bashkohen lëndës pufërike mjaftueshëm për të ulur vlerën e aciditetit në gjak.

Fermeri, i cili vlerëson se nuk mund të përmbushë mjaftueshëm planin e pirjes duhet që minimumi në mes të dy pirjeve të qumështit (në mëngjes dhe darkë) të ofrojë 2 herë (mesditë dhe darkë) lëngje me elektrolite. Sasia mund të llogaritet në mënyrë që viçat të marrin sasinë e nevojshme të qumështit dhe lëngjeve me elektrolite. Kjo është zgjidhja e dytë më e mirë por më e mirë se sa kur racioni i plotë i qumështit zëvendësohet- ashtu siç praktikohet shpesh- me “lëngje dietike”. Sipas mënyrës së këshilluar shumica e viçave, të cilët diagnostikohen shpejt me diare mund të ruhen nga tharja dhe rritja e aciditetit në gjak. Kjo sjell uljen e masave të nevojshme të trajtimit që duhen ndërmarrë tek viçat e sapolindur me diare.

Nëse viçat nuk pijnë ose pijnë keq (ose rrinë shtrirë pa lëvizur) për shkak të tharjes së lëkurës dhe rritjes së aciditetit në gjak atëherë humbjet e pësura nga diareja duhet të zëvendësohen duke ia dhënë me infuzion.



- Në praktikë në shumicën e rasteve kjo bëhet në formën e një infuzioni të shpejtë në venën e qafës.
- Tek viçat me tharje të lëkurës (venitje e syve, qëndrim shtrirë pa lëvizur) infuzioni i vazhdueshëm është e vetmja masë e cila mund të shpëtojë viçin. Kjo mund të përdoret edhe në kushtet e stallës pa asnjë problem (në kushtet praktike).

Elektrolitet e lëngshme duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Ato duhen të kenë një përbërje të thjeshtë. Duhet të merren parasysh rekomandimet e OBSH (Organizata Botërore e Shëndetit) për tretjen e elektroliteve si tek foshnjat me diare (3,5 g NaCl, 2,5 g NaHCO₃, 1,5 g KCL dhe 20 g glukozë për 1 litër). Sa më shumë të devijohet nga receta e rekomanduar nga OBSH aq më të papërshtatshme janë lëngjet!
- Përbërësit duhet të deklarohen qartë. Është e padobishme nëse në etiketën e produktit të rreshtohen përbërës dhe grupe përbërësish, ku veterinerit dhe fermerit (pra përdoruesit) nuk i jepet informacion mbi përqindjen ekzakte të përbërësve. Në fund të fundit vendimtare është se në çfarë mase është i përfaqësuar një substancë në një litër lëng. Vetëm kështu mund të krahasohen vlerat e lëngjeve të ndryshme (dhe me rekomandimet e OBSH).
- Lëngjet duhet të jenë të thjeshta për t'u përdorur. Për këtë arsye paketimi në paketa të vogla është më i përshtatshëm se paketimi në sasi të mëdha. Dozimi i saktë dhe sasia që nevojitet duhet të jenë të qarta në manualin e përdorimit.
- Duhet patjetër që tek manuali i përdorimit të tregohet mbi rreziqet e mundshme (për shembull për një rrezik helmimi nga një koncentrim i tepërt i kripërave tek lëngjet e dhëna).
- Pijet duhet të jenë "të përballueshme financiarisht". (Sa më shumë përbërës edhe pse në shumicën e rasteve efekti i tyre nuk bazohet në asnjë studim shkencor aq më shumë rritet çmimi).
- Në të ardhmen ato duhen deklaruar si mjekime dhe jo siç deklarohen tani, si ushqim "plotësues". Në të ardhmen ato duhen të emërtohen si pije kompensuese ose lëngje elektrolitesh. Meqenëse viçi i sapolindur nuk ka nevojë për dietë dhe nuk është e nevojshme një zëvendësim i qumështit, emërtime si "dietë apo lëngje zëvendësues" janë të gabuara dhe të ngatërrueshme.

Koment për përdorimin e lëngjeve me elektrolite tek viçat me diare:

- **Shpëtojnë jetë në formën e pirjeve të ndërmjetme** (shiko planin e pirjes) sepse ato zëvendësojnë lëngjet dhe elektrolitet.
- **Nuk është një mjet kundër diaresë.** Prandaj përdorimi i tyre nuk duhet të ndalojë edhe nëse diareja nuk ndalon pas disa ditësh.
- Nuk janë **zëvendësues për qumështin**, sepse ato nuk mund të mbulojnë nevojat për lëndë ushqyese dhe energji të viçit.
- Duhet të përgatiten sipas udhëzimeve të prodhuesit sepse ekziston rreziku i helmimit nga kripërat.
- Nuk duhet të jepen me qumësht sepse mund të ndikojnë negativisht tek fermentimi dhe tek fazat e tjera të tretjes.
- Lëngje me kombinime komplekse, siç ofrohen një numër i madh i tyre në treg, nuk nevojiten për zëvendësimin e humbjeve patologjike të lëngjeve dhe elektroliteve.